# AGJENDA TRAINIM

Lezhë 23 Tetor 2023

**Titull:**

Shoqëria Civile dhe Parlamenti në Procesin e Hartimit, Konsultimit dhe Miratimit të Buxhetit të Shtetit

**Organizator:**

AIS promotor i Open Data Albania

**Projekti dhe Partneriteti:**

Rritja e Përgjegjshmërisë së Parlamentit ndaj shqetësimeve të Qytetarëve, Projekt i mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë dhe zbatuar nga një konsorcium drejtuar nga IDM në partneritet me Citizens Channel dhe AIS.

**Objektiv:**

Ngritja e kapaciteteve të OSHC-ve, aktivistëve dhe mediave lokale për të kontribuar në planifikimin e buxhetit të shtetit dhe për politikat e shpenzimeve publike

**Zona:**

Rajonet: Lezhë; Dibër; Shkodër; Kamzë; Kukës; Tiranë; Malësi e Madhe

**Target:**

Përfaqësues të Shoqërisë Civile; Aktivist dhe Gazetarë Lokal

**Parashtrim Projekti**

Me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Tiranë, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në partneritet me Citizens Channel dhe me Institutin Shqiptar të Shkencave (AIS), do të zbatojnë projektin *"Rritja e përgjegjshmërisë së parlamentit ndaj shqetësimeve të qytetarëve"*. Ky projekt ka për qëllim të forcojë përpjekjet e parlamentit për të nxitur një mjedis mundësues për angazhim të qenësishëm të qytetarëve në proceset e politikave dhe legjislative në vend, si një mjet për të nxitur interesin publik dhe ndërtimin e besimit ndaj institucionit.

**Parashtrim Aktiviteti**

Ky Trajnim që do të mbahet në muajin Tetor 2023 në dy nga Rajonet e targetuara, ka si synim rritje të kapaciteteve të shoqërisë civile dhe përmirësim të tyre në njohjen dhe pjesëmarrje gjatë ciklit të Buxhetimit në Parlament. Trajnimi synon aftësim për të kuptuar dhe monitoruar Procesin e Hartimit, Miratimit dhe Raportimit të Buxhetit të Shtetit në Parlament. Ngritje e kapaciteteve të tyre për të reaguar dhe marrë pjesë gjatë procesit të Planifikimit dhe Miratimit të Buxhetit të Shtetit dhe Politikave që lidhen me Financat Publike. Trajnimi synon edhe prezantimin e Instrumenteve të Mundshëm Ligjor për pjesëmarrjen, propozime apo seanca dëgjimore në Komisione Kuvendore.

**Target:**

Aktivist, Gazetarë dhe Përfaqësues të Organizatave jo Qeveritare.

| | |
|---|---|
| **9.30 - 09:45** | Regjistrimi i Pjesëmarrësve |
| **09:45 - 10:45** | **Leksion: Buxheti i Shtetit si një Instrument i Rëndësishëm Kushtetues**<br>• Hartimi, Zbatimi dhe Raportimi i Buxhetit<br>• Procesi i Zbatimit dhe i Raportimit të Buxhetit<br>• Shpenzime dhe të ardhura Qeveritare<br>• Seanca Dëgjimore për Hartimin e Buxhetit<br>• Aktorët Civil dhe Instrumentet e Pjesëmarrjes Parlamentare për Buxhetin<br>• Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Raporti mbi Zbatimin e Buxhetit të Shtetit<br>• Pyetje dhe Përgjigje. Diskutim<br><br>Trajner: VIKTOR GUMI, EKSPERT LIGJOR |
| **10:45 – 11.45** | **Ushtrim Praktik**<br>Instrumente dhe Mundësi të një Organizate. Grup Interesi apo Komuniteti Lokal të kërkojë të dëgjohet dhe të propozojë çështje që lidhen me Buxhetimin në Kuvend. Buxheti për Sektor, Projekte dhe Investime<br>Listim i etapave dhe zhvillimet që çojnë në një Propozim të Suksesshëm.<br><br>Lehtësues: SIDORELA DRIÇI , PAJTIM NIKOLLI |
| **12:00- 12:45** | **Pushim dhe Dreka** |
| **13.00 – 14.00** | **Leksion: Buxhetimi Publik dhe Impakti Rajonal. Shpërndarja e Programeve dhe Investimeve në Qarqe**<br>• Dallimi mes Buxhetit Qeveritar dhe Buxheteve Lokale<br>• Të ardhurat e Pushtetit Vendor dhe rialokimet përmes Buxhetit të Shtetit<br>• Fondi i Zhvillimit të Rajoneve<br>• Rregulla të Caktimit të Transfertave të Pakushtëzuara. Qëllimi dhe Ecuria<br>• Impakti i Buxhetit të Shtetit në Zhvillimin e Investimeve Rajonale<br>• Ilustrimi përmes Artikujve të Publikuar në Open Data Albania<br>• Roli i Përfaqësuesit të Popullit, Deputeti dhe Shpërndarja e Parave Publike<br><br>Trajner: BLERINA LESI, EKSPERT FINANCA PUBLIKE |
| **14.00 – 15.50** | **Pune Praktike: Advokim mbi një Kauzë ku kërkohet nga Parlamenti Buxhetim më i mirë për Projekt/ Funksion apo Grup Interesi**<br>Trajner : ARANITA BRAHAJ, EKSPERTE KOMUNIKIM PUBLIK DHE FORCIM KOMUNITETI |
| | **Diskutime dhe Konkluzione.** |